



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 968 Prot.

Tiranë, më 24.7 2018

VENDIM Nr. 158, datë 18.07.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7 të datës 18.07.2018, pasi shqyrtoi kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Godinë banimi 2 kat" të Z. Sefo Zylfo Xhelollari dhe Z. Njazi Haki Malo, Zona Kadastrale 8512, Lagjia Nr. 2, rruga "Kajo Karafili", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e ALUIZNI-it Durrës për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit "Godinë banimi 2 kat" të Z. Sefo Zylfo Xhelollari dhe Z. Njazi Haki Malo, Zona Kadastrale 8512, Lagjia Nr. 2, rruga "Kajo Karafili", i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO RUXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al